

RAPORT FINAL I EKSPERTËVE TË JASHTËM

Kolegji “Gjilani” në Gjilan

KOMISIONI I EKSPERTËVE TË JASHTËM

Prof. Dr. Monika Petermandl

Prof. Dr. Dieter Petzold

Kryesuar nga Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA)

16th Prill 2015

Hyrje

Ky raport përmbledh rezultatet e procesit të vlerësimit të Kolegjit "Gjilani" në Gjilan të kryer në Mars 2015.

Kolegji "Gjilani" është ri akredituar në nivelin institucional në vitin 2014 si dhe në nivel të programeve të studimit: Bachelor në Banka, Financa dhe Kontabilitet/ BA, Menaxhment/ BA dhe Juridik të Përgjithshëm/ LLB. Sa i përket programeve master, programi Master në Menaxhment/ MA së pari është akredituar në vitin 2011 dhe është ri akredituar në vitin 2012, programi Master në Drejtësi Penale (LLM) është akredituar për herë të parë në vitin 2013.

Kolegji "Gjilani" tani ka aplikuar me programet si në vijim:

Ri/akreditim i programit Master në Menaxhment/ MA
Akreditimi i programit Bachelor Gjuhë dhe Letërsi Angleze/ BA

Qëllimi i këtij raporti është ti mundësohet Agjencisë së Kosovës për Akreditim dhe Autoriteteve Ministrore/ dhe apo Politike që të marrin vendim sa i përket ri/akreditimit të këtij programi Master dhe akreditimin e programit Bachelor. Ky raport i vlerësimit është hartuar në përputhje me kërkesat dhe udhëzuesit e Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për akreditimin e programeve të studimit.

Rekomandimet e shprehura në këtë raport janë adresuar tek Dekanati dhe anëtarët e tjerë të stafit akademik dhe atij mbështetës të Kolegjit "Gjilani" dhe ata kanë pranuar sugjerimet e bëra në lidhje me sfidat dhe mundësitë për zhvillimet e ardhshme të programeve. Këto rekomandime reflektojnë atë se çfarë autorët e konsiderojnë si standard të mirë në sistemet e arsimit të lartë, pa dashur që të paragjykojnë kushtet e ndryshme të cilat mbizotërojnë në Kosovë. Prandaj, vendimi final për aplikacionin e Kolegjit "Gjilani", përkatësisht për akreditimin dhe ri akreditimin e programeve do të bëhet nga autoritetet relevante. Autorët janë të vetëdijshëm për periudhën e vështirë nëpër të cilët arsimit terciar është duke kaluar, si dhe është në dijeni për kushtet ekonomike në Kosovë mirëpo me qëllim të zhvillimit të cilësisë në të ardhmen, Kosova duhet të pranojë standardet e përgjithshme të cilat aplikohen në Bashkimin Evropian.

*Më 14 Prill 2015 ekspertët kanë pranuar nga AKA **Komentet e Kolegjit Gjilani** për draft raportin e vlerësimit. Ekspertët falënderojnë përfaqësuesit e kolegjit të cilët kanë lexuar me kujdes raportin dhe janë pajtuar me rekomandimet. Ekipi i ekspertëve çmon përpjekjet e Kolegjit Gjilani për të përmbushur rekomandimet.*

Pjesa 1: Vlerësimi i programit Master Menaxhment (MA)”

1. Burimet e informimit

1.1 Ky vlerësim bazohet në dokumentet e specifikuara më poshtë të cilat i janë dërguar ekipit të ekspertëve para dhe pas vizitës në Kolegjin Gjilani më 12 Mars 2015 dhe në bazë të dëshmimeve që ekspertët kanë mbledhur gjatë vizitës, në takimet me stafin menaxhues të Kolegjit:

Naser Sadiku (Dekani)
Naim Mustafa (ProDekani)
Alban Hyseni (Zyra për Sigurimin e Cilësisë)

Dhe me personat përgjegjës për programin “Menaxhment” (MA):

Hivzi Sojeva (përgjegjësi i programit)
Shpresim Vranovci (asistent në programin e studimit)
Ahmet Maloku (zyra për hulumtim)

Përpos kësaj, raporti është bazuar në përshtypjet e fituara gjatë vizitës së ambienteve të Kolegjit dhe në bazë të takimeve me stafin akademik dhe studentët e regjistruar në programin “Menaxhment (MA)”.

1.2 Dokumentet relevante për vlerësimin e programit të studimit “Menaxhment/ MA, të cilat ekspertët i kanë pranuar para vizitës së ekspertëve janë:

Raporti i Vet Vlerësimit i Kolegjit “Gjilani” i datës 30 Shtator 2014, përfshirë përshkrimin e plotë të lëndëve të programit “Menaxhment”/ MA, si dhe CV-të e profesorëve (të cilat nuk ishin komplete).

CV të cilat kanë munguar i janë dërguar ekspertëve gjatë vizitës së ekspertëve.

Përpos këtyre dokumenteve, AKA ka dërguar “listën e stafit të deklaruar akademik të Kolegjit Gjilani”.

1.3 Dokumentet të cilat ekspertët i kanë pranuar pas vizitës janë:

Pasqyra e kurrikulës së programit 2 vjeçar “Menaxhment”/ MA me emrat e aktualizuar të profesorëve

Pasqyra e kurrikulës së programit 1 vjeçar “Menaxhment/ MA” me emrat e aktualizuar të profesorëve (për studentët të cilët kanë diplomuar nga programi Bachelor 4 vjeçar).

2. Përbushja e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Vlerësimit të vitit 2012 sa i përket ri akreditimit të programit “Menaxhment/ MA”

Rezultatet e të mësuarit janë formuluar në mënyrë më konkrete dhe janë lidhur me qëllimet e deklaruara të programit të studimit. Ato janë përmbledhur nën titujt “Njohuritë dhe të kuptuarit”, “aftësitë informative (njohëse)” dhe “Aftësitë praktike dhe profesionale” (RVV f.

21, 22). Duhet të konsiderohet nëse fokusi duhet të vihet në “Aftësitë sociale” (të ashtuquajturat “aftësitë e buta”, të tilla sikurse komunikimi, negocimi, udhëheqja, puna në ekip), pasi që këto janë faktorët kyç në menaxhimin e suksesshëm. Aftësitë sociale mund të gjenden si pjesë integrale të lëndës “Menaxhment” (Semestri 1), megjithatë këto duhet të theksohen më tepër. Për më tepër, ato mund të zhvillohen me metoda të përshtatshme të mësimdhënies dhe mësim marrjes.

Përshkrimet e rishikuara të lëndëve tani përfshijnë informacione sa i përket metodave të mësimdhënies dhe mësim marrjes.

Strategjia e hulumtimit tani është implementuar pjesërisht, mirëpo më tepër në sektorin e hulumtimit juridik dhe ende ka ngecje në hulumtimin në menaxhment (shikoni kapitullin 5).

Procesi i Menaxhimit të Cilësisë është dokumentuar në detaje (RVV f. 106-110).

Përgjithësisht, mund të thuhet se rekomandimet e dhëna në raportin e vlerësimit të vitit 2012 janë përmbushur në një shkallë të lartë.

3. Programi i studimit dhe Menaxhimi i Studentëve

Programi Menaxhment/ MA korrespondon me deklaratën e misionit të Kolegjit “Gjilani” për ti kontribuar zhvillimit të qëndrueshëm të regjionit dhe për më tepër Kosovës. Dy specializimet e programit “Financa” dhe “Ndërmarrësi” përmbushin kërkesat për baza të shëndosha financimi të bizneseve dhe për fillimin e kompanive të reja, duke krijuar në këtë mënyrë mundësi të ardhshme ekonomike, përfshirë mundësitë e punës për të diplomuarit. Kurrikula lidhet me lëndët kryesore të menaxhmentit sikurse Marketing, Financa, Menaxhimi i Burimeve Njerëzore, Menaxhimi i Sistemeve të Informimit, Menaxhimi i Zingjirëve të Furnizimit, E Drejta Biznesore (në vitin e parë) dhe specializimin relevant ose në Financa dhe Ndërmarrësi në semestrin e tretë. Hyrja në Metodot e Hulumtimit ofrohet në semestrin e parë. Aplikimi i Metodave të Hulumtimit është fokus në semestrin e 4 (disertacioni), shoqëruar nga praktika e cila mundëson që hulumtimi të adoptohet me problemet praktike me të cilat kompanitë përballen. Duhet ti kushtohet vëmendje cilësisë akademike të disertacionit. Për më tepër ekspertët vlerësojnë “Rregulloret dhe procedurat për temat e diplomimit” (RVV f. 16, 17) të cilat thonë se secili studentët duhet të ketë një mentor (nga stafi akademik) si dhe një mentor të rastit (nga vendi i praktikës). Si përmbysje, ekspertët konfirmojnë se programi “Menaxhment/ MA” është i përshtatshëm për gradën akademike dhe korrespondon me standardet ndërkombëtare.

Eksperti nuk ka gjetur në RVV ndonjë përmbledhje të *konceptit didaktik të programit “Menaxhment/ MA”*. Megjithatë, specifikat e “formave të mësimdhënies dhe mësim marrjes”, të përmendura në secilin përshkrim të lëndëve, dëshmojnë përkushtimin e përgjithshëm të institucionit për metoda aktive të mësimdhënies dhe mësim marrjes. Ekspertët supozojnë se metodat e mësimdhënies dhe mësim marrjes janë të përshtatshme për arritjen e suksesshme të qëllimeve dhe rezultateve të programit, përfshirë zhvillimin e nevojshëm të aftësive sociale.

Pjesëmarrja e rregullt për studentët, përfshirë ligjëratat dhe ushtrimet, është 18 orë për një javë. Kjo mund ti ofrojë studentëve mundësi të mjaftueshme për studim të pavarur,

reflektime dhe analizë. Mirëpo duhet të merret parasysh se posaçërisht në studimet master, një përqindje e lartë e studentëve veçse është e punësuar apo drejtojnë bizneset e tyre private (ashtu siç është dëshmuar gjatë takimit të ekspertëve me studentët).

Ngarkesa zyrtare e punës për një semestër është ekuivalent me 30 ECTS. (1 ECTS llogaritet me 25 orë, që do të thotë se ka një ngarkesë prej 750 orëve në gjashtë muaj, apo përafërsisht 30 orë për një javë). Për disa studentë ky numër mund të paraqet sfidë për tu menaxhuar e gjithë kjo ngarkesë. Ekspertët pranojnë se megjithatë ata janë të familjarizuar me studentë shumë të motivuar të cilët mund të menaxhojnë këtë ngarkesë ekstreme të punës.

Secila lëndë në kurrikulë ka 6 ECTS. Arsyershmëria e kësaj mund të vihet në pikëpyetje.

Duket se ka rrezik po ashtu për dyfishime të panevojshme të përmbajtjeve në specializimin e Ndërmarrësisë, sa i përket lëndëve “Ndërmarrësi dhe Menaxhimi i NVM-ve” dhe “Strategjia e Ndërmarrësisë dhe Fillimet e Bizneseve”.

Kriteret për pranimin e studentëve në programin “Menaxhment/ MA” janë në përputhje me standardet ndërkombëtare: parakushtet për regjistrim janë përfundimi me sukses i programit studimor Bachelor me jo më pak se 180 ECTS, përpos kalimit të provimit pranues (nëse kandidatët kanë mesatare më të ulët se 7.5, apo gradë bachelor e cila nuk mbulon lëndët kryesore për një program të studimit në Menaxhment). Aplikuesit të cilët kanë diplomuar nga programet katër vjeçare mund të arrijnë gradën akademike master brenda një viti. Ekspertët kanë pranuar si dokumente shtesë, pasqyrën e kurrikulës së programit studimor 1 vjeçar. Kjo kurrikulë paraqet programin 2 vjeçar, me vetëm 18 ECTS të lëndëve të përgjithshme (të cilat fokusohen në Metodën e Hulumtimit dhe në Menaxhment) dhe 12 ECTS për specializim (të cilat koncentrohen në Menaxhimin Financiar përkatësisht në Ndërmarrësi dhe Menaxhimin e NVM-ve) dhe 30 ECTS për punën praktike dhe Disertacionin. Ekspertët kanë mësuar gjatë takimeve të tyre me studentë se një numër i madh i tyre janë pranuar në programin 1 vjeçar. Kjo mund të jetë kritike, pasi që këta studentë nuk kanë ndjekur programin e plotë të menaxhmentit. Ekspertët sugjerojnë që kandidatët me gradën akademike katër vjeçare duhet të inkurajohen të regjistrohen dhe të ndjekin programin dyvjeçar.

Në secilin vit të studimeve janë regjistruar 50 studentë të rregullt dhe 25 me korrespondencë në programin Menaxhment/ MA. Stafi akademik përbëhet nga 13 ligjërues për programin master. Mund të thuhet se *raporti në mes të stafit akademik dhe studentëve* është i kënaqshëm. Kjo është konfirmuar edhe gjatë takimit me studentët. Studentët çmojnë mjaft shumë raportin e ngushtë që ata kanë me ligjëruesit.

4. Stafi akademik

Ende duhet të bëhen përpjekje të shumta për të përmirësuar situatën e stafit akademik. Edhe pse në listën e stafit akademik, të dërguar nga AKA, mes 35 ligjëruesve të Kolegjit Gjilani, 16 janë paraqitur si *profesorë të rregullt*, vetëm 3 nga ta janë prezantuar në kurrikulën e programit “Menaxhment/ MA”. *10 ligjëruesit e tjerë janë profesorë të jashtëm*. Edhe pse mund të pranohet se për një kolegji të ri është vështirë për të pasur profesorë të

rregullt me kualifikime të larta për një program të studimit master, megjithatë në të ardhmen e afërt ky deficit duhet të tejkalohet duke ndërmarrë masa sistematike të zhvillimit të stafit. Hapat e parë mund të bëhen në punësimin e ligjëruesve të rinj të talentuar, duke iu dhënë atyre mundësinë që të bëjnë punë kërkimore dhe të zhvillojnë kompetencat e tyre mësimdhënëse, si dhe duke marrë pjesë në programe ndërkombëtare për shkëmbimin e stafit akademik. Në RVV (f. 98-100) janë përmendur masat të cilat do të ndërmerren për zhvillimin e stafit akademik. Këto masa duhet të vihen në praktikë.

Kualifikimet e stafit aktual akademik (edhe pse kjo vlen më tepër për ligjëruesit part time) janë të mjaftueshme. Ekspertët i kanë pasur në dispozicion CV-të e stafit akademik (përfshirë 3 prej tyre) dhe kanë mësuar gjatë takimit me stafin akademik se shumica e tyre janë të angazhuar në aktivitete të hulumtimit dhe të publikimit.

5. Hulumtimi dhe bashkëpunimi ndërkombëtarë

Ashtu siç është cekur më sipër, *stafi akademik është i përfshirë në aktivitete të hulumtimit brenda dhe jashtë institucionit*. Kolegji Gjilani ka themeluar Qendrën për Hulumtime e cila koordinon dhe stimulon punën kërkimore. Të dhënat relevante statistikore në RVV (f. 113-116) tregojnë një rritje të numrit të publikimeve dhe pjesëmarrjes në Konferencat Shkencore, Simpoziumeve dhe Seminareve. Përshtypja e ekspertëve është se për momentin puna kërkimore më shumë dominohet në fushën juridike ndërsa hulumtimi në fushën e menaxhmentit është lënë prapa.

Bashkëpunimi ndërkombëtarë në hulumtim dhe mësimdhënie është renditur në RVV (f. 117, 118). Shumica e tyre lidhen me hulumtim dhe me shkëmbimin e studentëve dhe stafit akademik. Partnerët janë organizatat evropiane dhe universitetet dhe kolegjet nga Ballkani, Turqia dhe Kosova (çka është premtuese për partneritet të qëndrueshëm). Gjithashtu premtuese duket se është edhe partneriteti me industrinë, me trupat profesionale dhe me agjencitë shtetërore brenda Kosovës (RVV f. 118).

Mjaft interesante është një lloj kapitulli programatik në RVV (f. 119-123, "Lidhja e hulumtimit me mësimdhënien në nivelin e institucionit dhe programeve të studimit), i cili përmbledh strategjinë e hulumtimit të Kolegjit "Gjilani". Gjithashtu përfshirja e studentëve në hulumtim është marrë parasysh në RVV (f. 114-116).

Përgjithësisht mund të konfirmohet se aktivitetet e hulumtimit dhe të bashkëpunimit të Kolegjit Gjilani janë në rrugë të mirë.

6. Financa dhe Infrastruktura/ Hapësirat dhe Pajisjet

Kolegji "Gjilani" ka një plan të detajuar të buxhetit. Bilanci dëshmon për një situatë stabile financiare (RVV f. 124-130).

Infrastruktura është adekuate për një institucion të arsimit të lartë. Pajisjet e TI shërbejnë për nevojat e administratës, stafit akademik dhe studentëve (RVV f. 112).

Biblioteka posedon libra relevante (p.sh. ekonomi, menaxhimi strategjik, kontabilitet, menaxhimi financiar, marketing) dhe ofron mundësi për ti lexuar ato libra edhe aty. Eksperti mirëpret faktin se literatura në fushën e menaxhmentit është bërë më prezente edhe në

gjuhën Shqipe, përpos literaturës në gjuhën angleze. Për më tepër, studentët kanë qasje edhe në baza të ndryshme të të dhënave online.

Ekspertët kanë shikuar dhe lexuar disa disertacione. Sa i përket cilësisë së tyre, kolegji duhet të jetë më ambicioz për të rritur standardin shkencor të hulumtimit të studentëve.

Deri më tani ligjëratat janë mbajtur në salla të mëdha. Përpjekje duhet të bëhen që të ofrohen edhe zyra për stafin e brendshëm akademik.

7. Menaxhimi i Cilësisë

Sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë është bërë një nga pikat më të forta të Kolegjit "Gjilani". Qëllimet janë gjithëpërfshirëse dhe procesi është elaboruar mjaft mirë. Ekspertët dëshirojnë të theksojnë "rregulloret sa i përket procedurave për sigurimin e cilësisë së programit". Në këtë proces rol të rëndësishëm luan edhe angazhimi i palëve të interesit si dhe standardizimi me palët e treta.

8. Përfundim

Vendimi në vijim është bërë duke pasur parasysh përmirësimet të cilat janë bërë nga Kolegji Gjilani gjatë viteve të kaluara, në bazë të standardit të cilësisë i cili aktualisht është arritur, dhe

Ekspertët rekomandojnë ri/akreditimin e programit "Menaxhment/ MA" për një periudhë tri vjeçare.

Ekspertët dëshirojnë të ofrojnë rekomandimet pasuese të cilat kanë për qëllim përmirësimin e programit "Menaxhment/ MA":

Rekomandimet

Për programin:

- Të konsiderohet zhvillimi i aftësive sociale përmes përmbajtjeve të përshtatshme të mësimdhënies/ apo metodave të mësimdhënies dhe trajnimeve,
- Të shmangen dyfishimet e panevojshme të përmbajtjeve në lëndët "Ndërmarrësi dhe Menaxhimi i NVM-ve" dhe "Strategjia e Ndërmarrësisë dhe Fillimet e Bizneseve",
- Të vlerësohet ngarkesa reale e punës për studentët për të mësuar nëse i tejkalon apo është nën kufirin e përcaktuar të ECTS-ve. Të merren masa nëse është e nevojshme,
- Të shqyrtohet nëse është e arsyeshme që gjitha lëndët të llogariten njëjloj me 6 ECTS,
- Të inkurajohen aplikuesit që të regjistrohen në programin master 2 vjeçar edhe nëse ata kanë përfunduar studimet e tyre katër vjeçare,
- Të ngritet standardi shkencor i disertacioneve në përputhje me kërkesat ndërkombëtare.

Për stafin:

- Të zbatohet plani zhvillimor për stafin akademik. Të ri konsiderohen metodat e mëtejme për zhvillimin e stafit të cilat vëmendje të veçantë i kushtojnë studimeve të nivelit master.

Pjesa 2: Vlerësimi i programit Bachelor “Gjuhë dhe Letërsi Angleze (BA)”

1 Burimet e informacionit

1.1 Ky vlerësim është bazuar në dokumentet e specifikuar më poshtë të cilat i janë dërguar ekspertëve para dhe pas vizitës së ekspertëve në Kolegjin Gjilani më 12 Mars, 2015 dhe në bazë të dëshmimeve të mbledhura gjatë vizitës, në takimet me anëtarët menaxhues të Kolegjit Gjilani dhe në veçanti me personat përgjegjës të programit “Gjuhë dhe Letërsi Angleze”:

Avni Islami
Assoc. Prof. Dr. Brikena Xhaferi-Islami
Agim Poshka

Përpos kësaj, raporti është bazuar në përshtypjet që ekspertët kanë marrë gjatë vizitës së hapësirave të Kolegjit dhe gjatë takimeve me stafin akademik dhe studentët të cilët ishin përfshirë në programin Master Menaxhment.

1.2 Dokumentet relevante për vlerësimin e programit studimor “Gjuhë dhe Letërsi Angleze” të cilat ekspertët i kanë pranuar (në formë elektronike) para vizitës ishin:

1.2.1. *Raporti i Vet Vlerësimit i Kolegjit Gjilani i datës 30 Shtator 2014* (përpos kësaj, ekspertëve iu është dorëzuar edhe raporti i printuar i vlerësimit; tutje i referuar si RVV);

1.2.2 Gjithsejtë 27 përshkrime të lëndëve (syllabuseve) për programin e studimit;

1.2.3. CV-të e stafit akademik si në vijim:

Assoc. Prof. Dr. Brikena Xhaferi
Assoc. Prof. Dr. Ferit Rustemi
Prof. Dr. Vedat Kiseri
Shprese Qamili, PhD.

1.2.4 AKA “lista e stafit të deklaruar akademik të Kolegjit Gjilani”

1.3 Dokumentet e konsideruara nga ekspertët pas vizitës ishin:

1.3.1 Lista e stafit akademik për programin Gjuhë dhe Letërsi Angleze

1.3.2 CV-të e stafit akademik:

Agim Poshka
Avni Islami
Bachtijar Kryesiu
Florent Sylejmani
Selim Sylejmani
Xhemajl Ahmeti

Koment për dokumentet 1.2.1 dhe 1.2.2

“Syllabuset” (1.2.2) dhe seksioni 2.14 (Përshkrimet e lëndëve) në RVV janë përshkrimet e lëndëve të cilat përbëjnë programin e studimit “Gjuhë dhe Letërsi Angleze”; megjithatë, ato dallojnë mjaft shumë si në përmbajtje ashtu edhe në formën e tyre. Pasi që “Syllabuset” përmbajnë mjaft gabime (për shembull, 12 lëndë janë përshkruar për semestrin 1, vetëm 1 për të parin, 3 për të tretin, etj.) megjithatë gjatë takimeve ne jemi pajtuar që vlerësimi i programit të studimit do të bëhet bazuar në informacionet që janë relevante nga pjesët e RVV-së. Megjithatë, “Syllabuset” do të konsultohen herë pas here në rastin kur mungojnë informacionet nga RVV 2.14.

2 Koncepti i programit BA (Vëzhgimet dhe komentet në seksionet 2.1 deri 2.12 të RVV-së)

2.1 Programi i studimit në kontekstin e tregut të punës

Në RVV 2.2, është thënë se Kolegji Gjilani do të jetë institucioni i parë i cili do të ofrojë program në Gjuhë dhe Letërsi Angleze në regjionin e Anamoravës. Gjatë takimeve është theksuar disa herë se në këtë regjion ka një kërkesë të lartë për të pasur një program të tillë; çfarë mbetet e paqartë është se në cilën fushë të tregut të punës ekziston kjo kërkesë. Gjatë takimit me kolegët përgjegjës për programin e studimit, është thënë se deri më 85% të të diplomuarve do të drejtohen në mësimdhënie

Koment: *Duke pasur parasysh se (sipas informacioneve të ofruara nga përfaqësuesit e AKA-së) të diplomuarit nga institucionet private të arsimit të lartë nuk pranohen në pozita si mësimdhënës nëpër shkolla publike, kjo e dhënë nga institucioni duket se është ekzagjeruar shumë. Përderisa është e vërtetë se ka vështirësi dobia e programeve në shkencat humane brenda tregut të punës, fakti se vetëm një numër i vogël i të diplomuarve do të ketë mundësi të kyçet në mësimdhënie, ky fakt duhet të reflektohen në program.*

2.2 Marrëdhënia në mes të teorisë dhe pjesës praktike të programit të studimit

Sa i përket raportit në mes të pjesëve teorike dhe praktike të programit, seksioni 2.8 i RVV-së përmend shifrat “15-35%” (të cilat janë përsëritur në të gjitha përshkrimet e lëndëve) pa deklaruar qartë se me çfarë lidhen ato. Staf akademik të cilat eksperti i kishte pyetur për këtë çështje, nuk ishin në gjendje që të sqaronin këtë çështje në një nivel të kënaqshëm; ata kanë përmendur mundësitë e “punës praktike” pa qenë më specifik në deklarinimin e mangët që është bërë në RVV 2.10.

Në këtë kontekst, mundësitë e studentëve për të kaluar kohë në shtete të huaja ku flitet gjuha angleze është diskutuar shumë pak. Përderisa gjithë janë pajtuar se ekziston dëshira për mundësitë e tilla (për shembull përmes programeve sikurse ERASMUS), duket se institucioni nuk ka ndërmarrë asnjë masë konkrete në këtë aspekt.

Koment: *Përderisa mungesa e të dhënave specifike dhe fakteve nuk është e kënaqshme, është evidente se këto informacione dhe të dhëna në këtë pikë janë vështirë për tu kuptuar. Megjithatë, do të ishte e dëshirueshme që kontaktet dhe programet e shkëmbimit të krijohen sa më shpejtë që të jetë e mundur.*

3 Kurrikula (Vëzhgimet dhe komentet në seksionet 2.13 dhe 2.14 të RVV-së)

3.1 Lëndët obligative dhe zgjedhore

Ekzistenca e lëndëve zgjedhore është esenciale që ti mundësojë studentëve të specializojnë në studimet e tyre, në përputhje me qëllimet K2 dhe K3 të specifikuar në RVV 2.7. Duke pasur parasysh se “Pasqyra e programit (RVV 2.13) tregon se programi – edhe pse përmban disa lëndë të shënuara me “E” – në fakt nuk lejon asnjë zgjidhje duke pasur parasysh se shumica e pikëve kredi të bashkangjitura në gjitha lëndët që ofrohen në semestra kanë shumën minimale (të 30 ECTS) që kërkohet për një semestër (RVV 2.9). Prandaj programi nuk ofron asnjë mundësi për tu specializuar.

Koment: Ky element është një defekt shumë i madh pasi që një pjesë shumë e madhe e fushës së gjuhës angleze dhe pjesëve profesionale të gjuhës angleze (mësimdhënia, biznesi, marrëdhëniet me publikun, turizmin, marketingu, gazetaria, etj.) duke pasur parasysh se mundësia për specializim është esenciale për këtë program.

3.2 Struktura e programeve të studimit

Për arsyet e dhëna më sipër, dallimi në mes të lëndëve obligative dhe zgjedhore do të injorohet në analizat e mëposhtme. Për shkak të diskrepancave në mes të “Pasqyrës së Programit (RVV 2.13) dhe përshkrimeve pasuese të lëndëve (përshkrimet e lëndëve/ moduleve, RVV 2.14), dëshmitë nuk janë shumë të qarta; megjithatë, lëndët e ofruara mund të ndahen në kategoritë e mëposhtme:

- a) Zotërimi i gjuhës: 5 lëndë, të shpërndara në 5 semestra, me një numër të përgjithshëm prej 30 kredive;
- b) Linguistika: 12 lëndë, të shpërndara në 6 semestra, me një numër të përgjithshëm të 70 kredive;
- c) Mësimdhënia e Gjuhës Angleze si një Gjuhë e Huaj (TEFL): 3 lëndë, të shpërndara në 2 semestra, me një shumë të përgjithshme prej 16 kredive;
- d) Gjuha shqipe dhe gjuha gjermane: 4 lëndë, të shpërndara në 3 semestra, me një shumë të përgjithshme të 19 kredive;
- e) Aftësitë bazë (të studimit dhe hulumtimit): 1 lëndë, në semestrin e parë, me 4 kredi.

Përpos kësaj, “Pasqyra e programit” përmend edhe punimit e “temës së diplomës” me 8 pikë kredi, mirëpo nuk ka asnjë informacion të mëtejshëm se si do të vlerësohet dhe do të monitorohet puna në këtë pjesë shumë të rëndësishme të programit.

Në përshkrimin e lëndës të listuar në RVV 2.14, ka pak informacione për “Metodat e vlerësimit dhe për kriteret e kalueshmërisë”; ka më shumë informacione në “Syllabuset” edhe pse ka kontradikta në disa raste.

Nuk ka informacione për përbërjen e notës finale (përfundimtare) apo për kriteret e kalueshmërisë.

Komente:

Zotërimi i gjuhës dhe Linguistika: është e dukshme që zotërimi i gjuhës duhet të jetë qëllimi i parë dhe kryesor i çdo programi të gjuhës dhe letërsisë angleze. Sipas përshkrimeve të lëndëve, ka disa lëndë specifike të gjuhëve sikurse “Gjuha Angleze” 1 dhe 2 si dhe lëndët në Linguistikë të cilat kanë për qëllim ti kontribuojnë këtij qëllimi; megjithatë, përgjithësisht programi karakterizohet nga një theks i madh i Linguistikës. Fakti se lëndët e dyfishta si “Bazat për Gramatikën Angleze”, “Fonetika dhe Fonologjia”, “Morfologjia” dhe “Sintaksa” kanë secila vetëm nga një përshkrim të vetëm është

një indikacion për një mungesë të përgjithshme të një strukture konsistente të kësaj pjese të programit.

Letërsia dhe studimet kulturore: *definitivisht ka shumë pak lëndë në fushën e letërsisë dhe studimeve kulturore. Në kontrast, të diplomuarit nga lëndët gjuhësore, studentët me BA në gjuhë dhe letërsi angleze pritet që të njihen me së paku identitetet kulturore të vendeve anglisht folëse. Prandaj është shumë e rëndësishme që studentët të njihen jo vetëm me letërsinë e këtyre shteteve mirëpo edhe me historinë e tyre, traditat, etj. Lëndët e ofruara në këtë program janë të pamjaftueshme në këtë aspekt si dhe në aspektin didaktik. Ndoshta për shkak të konceptit naiv të kronologjisë, letërsia e vjetër angleze, ndoshta lënda më e vështirë, është vendosur në semestrin e parë, dhe pastaj vihen në mënyrë fare sistematike dhe jo kronologjike, lëndët për letërsinë viktoriane, romantizmin, novelat e shekullit 18 dhe hyrja në letërsinë angleze të shekullit 20 dhe 21. Përderisa fushat e rëndësishme si drama në renesancë (përfshirë Shekspirin) dhe e gjithë letërsia Amerikanë është neglizhuar tërësisht.*

Përderisa mirëpritet se programi përmban një lëndë në fushën e Studimeve Kulturore (Civilizimi Britanik dhe ai Amerikan), duhet të theksohet se kjo sigurisht se është e pamjaftueshme. Përpos kësaj, kjo lëndë në njërin anë është shumë ambicioze pasi që përpiqet që të mbulojë një fushë ekstremisht të gjerë, dhe në anën tjetër është e pamjaftueshme pasi që ka të bëjë me vetëm shekullin e 19-të.

Çfarë absolutisht mungon nga programi është një lëndë e cila i prezanton studentët me teorinë e ndryshme të letërsisë dhe interpretimit.

TEFL: *Të tria lëndët janë të përshtatshme për fundin e kurrikulës (semestri 5 dhe 6); mënyra se si këto lëndë janë lidhur në mes veti mbetet ende e paqartë pasi që vetëm njëra nga to (Metodologjia e Gjuhës Angleze) është përshkruan në RVV 2.14 përderisa përshkrimet në Syllabuset janë pjesërisht kontradiktore dhe pjesërisht të mangëta. Përpos kësaj mund të thuhet se lëndët në TEFL duhet të jenë lëndë zgjedhore dhe jo lëndë obligative pasi që jo gjithë studentët dëshirojnë të drejtohen kah mësimdhënia.*

Gjuha shqipe dhe gjermane: *Përderisa është e qartë se studentët e gjuhës angleze kanë njohuri të mira të gjuhës së tyre armëtarë dhe zotërojnë pak një gjuhë të huaj të dytë, këto fusha janë dhe duhet të jenë pjesë e kurrikulës. Megjithatë, aranzhimi i tyre mund të tolerohet duke pasur parasysh se kombinimi duket se është i zakonshëm në Kosovë.*

Aftësitë bazë: *Lënda për "Shkrimin Akademik" është padyshim shumë e dobishme; megjithatë mbetet mister arsyeja pse kjo lëndë është vendosur në semestrin e parë në vend se të vendosej në njërin nga semestrat e fundit për hartimin e temës së diplomës.*

4 Stafit akademik

4.1. Vëzhgime

4.1.1 Lista e stafit e cila i është dërguar ekspertëve pas vizitës përbëhet nga 10 persona prej të cilëve 5 janë të punësuar me orar të plotë dhe 5 me part time. Lista nuk është në pajtueshmëri të plotë me programin ashtu siç është prezantuar në RVV 2.13 dhe 2.14, ku nuk përmenden fare Agim Poshka, dhe Shpresa Qamili përderisa Dr. Vesel Nuhiu, personi i përmendur si mësimdhënësi i Lëndëve

Sintaksa 1 dhe 2, nuk është fare në listë. Megjithatë, Prof. Poshka shfaqet si mësimdhënës në Syllabuset e lëndëve nr. 14 (Përkthimi jo bukfal), nr. 15 (Testimi dhe Vlerësimi) dhe nr. 24 (Sintaksa II). Ngjashëm, Shpresa Qamili përmendet si mësimdhënëse në Syllabuset e lëndëve “Bazat e Gjuhës Gjermane” (nr. 3) dhe “Gjuhë Angleze II” (nr. 20).

4.1.2 Lista e stafit po ashtu është në kundërshtim me “listën e stafit të deklaruar akademik të Kolegjit Gjilani” të dërguar nga AKA, e cila përmban vetëm emrat e: Avni Islami, Shpresa Qamili, Ferit Rrustemi, Brikena Xhaferi – Islami, Vedat Kiseri, Agim Poshka. Përpos kësaj, ekspertët janë këshilluar nga AKA se ata duhet të “konsiderojnë si staf akademik vetëm ata persona të cilët janë në këtë listë (e-mail i datës 10 Mars, 2015) dhe se “z. Poshka, z. Rrustemi dhe znj. Xhaferi nuk janë staf full time në Kolegjin Gjilani për programin e studimit në Gjuhë dhe Letërsi Angleze. Ata kanë punësim të përhershëm në Maqedoni” (e-mail i datës 19 Mars, 2015).

Koment

Fakti se informacionet për stafit e mundshëm akademik janë aq konfuzë dhe kontradiktore, konfirmojnë përshtypjen e ekspertit që programi është hartuar pa kujdesin e duhur. Përpos faktit se nën këto rrethana mbetet e paqartë se cilët persona janë caktuar si mësimdhënës për cilat lëndë, gjithë stafi akademik duket se është i kualifikuar për detyrat e tyre të mësimdhënies, sipas CV-ve të cilat janë ofruar. Duhet të theksohet po ashtu se Prof. Rrustemi dhe Kiseri, janë paraparë të ligjërojnë 9 përkatësisht 5 lëndë, dhe se këta dy persona janë përtej moshës së pensionimit; dhe se dy persona (Prof. Kiseri dhe Prof. Xhaferi – Islami) janë në krye të gjitha lëndëve në letërsinë Britanike dhe Amerikane, historinë, dhe kulturën; dhe se nuk ka asnjë profesorë i cili ka si gjuhë armëtare gjuhën angleze.

5 Hapësirat

Gjatë vizitës ekspertët kanë vizituar sallat e mësimit, dhomën e kompjuterëve dhe bibliotekën.

Koment: *Ndoshta është e pashmangshme që në këtë fazë të planifikimit, biblioteka e Kolegjit nuk ka asnjë libër në fushën e studimeve angleze. Megjithatë, nuk ka pasur asnjë informacion konkret, asnjë indikatorë i cili do të tregonte se ekziston një program i cili ka për qëllim blerjen e letërsisë primare apo sekondare, si në formë të printuar ashtu edhe në formën elektronike, pas dhënies së akreditimit.*

6 Bashkëpunimi Ndërkombëtarë dhe Hulumtimi

Informacionet e përgjithshme të dhëna për këtë fushë në RVV duket se janë premtuese, mirëpo nuk ka informacione specifike për programin e studimit “Gjuhë dhe Letërsi Angleze”.

Koment: *Edhe pse kjo mund të mos jetë esenciale për një program BA të një niveli të lartë, është e dëshirueshme që të hartohen programe të bashkëpunimit me universitete dhe institucione të tjera në shtetet anglisht folëse, në veçanti me qëllimin që të ofrohen programe të shkëmbimit të studentëve për mësimdhënës universitar dhe për ti dhënë së paku disa studentëve disa mundësi për të studiuar jashtë vendit për së paku një kohë të shkurtër.*

7 Përfundim

Ashtu siç tregojnë vëzhgimet më sipër, programi “Gjuhë dhe Letërsi Angleze” në formën siç është paraqitur ka shumë mangësi. Për të përmbledhur, këto mangësi krijojnë përshtypjen që programi ka mungesë të një plani konsistent i cili bazohet në parime pedagogjike dhe ka mungesë të elementeve që përbëjnë një program të kualifikuar të Gjuhës dhe Letërsisë Angleze. Ndër mangësitë që janë përmendur më sipër, këto tri elemente janë më të rëndat:

- (1) Programi si tërësi është i pa-balancuar pasi që favorizon më tepër linguistikën sesa letërsinë dhe studimet kulturore, dhe në masë të madhe nuk i mbulon fare këto të fundit;
- (2) Duke ofruar një numër absolutisht minimal të lëndëve të nevojshme për të arritur numrin e nevojshëm të pikëve kredi ECTS, programi nuk ofron asnjë mundësi për specializim;
- (3) Në kontekst të kontradiktave të theksuara më sipër, duket se ka shumë dyshim nëse për momentin ky program ka në dispozicion staf akademik i cili është adekuat për programin e studimit.

Për këto arsye, në këtë pikë

Programi “Gjuhë dhe Letërsi Angleze” nuk mund të rekomandohet për akreditim.

8 Rekomandime

Në rast se Kolegji “Gjilan” konsideron mundësinë për të aplikuar përsëri për akreditimin e këtij programi pasi të kenë përmirësuar programin, eksperti ofron rekomandimet në vijim:

9.1 Rekomandime sa i përket kurrikulës:

- § Duhet të ketë numër të mjaftueshëm të lëndëve obligative dhe atyre zgjedhore në mënyrë që studentët të kenë lirinë që të ndjekin interesat e tyre dhe qëllimet profesionale, dhe gjithashtu duhet të ketë një politikë të përgjithshme në lidhje me atë se si përcaktohen lëndët në obligative apo në ato zgjedhore;
- § Në këtë kontekst, rekomandohet hartimi i njësive të mëdha arsimore të njohura si module (në përputhje me standardet evropiane), secila prej tyre duhet të përbëhet nga së paku dy lëndë pasuese të cilat janë të lidhura qartë me njëra tjetrën dhe të cilat formojnë blloqe të mëdha të cilat mundësojnë konsistencë më tepër më kurrikulën.
- § Në çdo rast, kurrikula duhet të përmbajë parimet në vijim: përderisa theksim i madh duhet ti vihet zotërimit të gjuhës dhe kuptimit adekuat të gjuhës, dhe nëse është e mundshme, aftësive të mësimdhënies, të diplomuarit e këtij programi BA duhet të kenë gjithashtu njohuri bazë për historinë dhe kulturën e vendeve kryesore anglisht folëse, sikurse për Britaninë e Madhe dhe SHBA-të, dhe njohuri dhe aftësi teknike të nevojshme për tu përballur me fenomenet aktuale dhe kulturore, në veçanti me letërsinë bashkëkohore mirëpo edhe me filmin dhe median.
- § Posaçërisht, rekomandohet që:
 - a) të ofrohen një sërë lëndë obligative, të shpërndara nëpër tre apo katër semestrat e parë, e të cilat ofrojnë të dhëna për letërsinë e Britanisë së Madhe dhe SHBA-ve, duke i

familjarizuar kështu studentët me tekste klasike nga Renesanca deri në kohët prezente dhe duke reflektuar gjithashtu ndërlidhjet në mes të letërsisë dhe historisë politike dhe historike, plus së paku një lëndë për teorinë e letërsisë dhe mediave që do të familjarizonin studentët me qasjet historike dhe qasjet aktuale të tilla sikurse Kritika e Re, Strukturalizmi, Narratologjia, Teoria e Zhanreve, Analizimi i Filmave, etj.;

b) që të ofrohen lëndë të specializuara në Letërsinë Angleze dhe Amerikane, si lëndë obligative dhe lëndë zgjedhore;

c) që të ofrohen disa lëndë për tekstet dhe zhanret moderne dhe bashkëkohore, përfshirë zhanret e famshme të tilla sikurse fantazia dhe fanta-shkenca, letërsia e fëmijëve dhe filmi;

d) që të merren masat për të siguruar se kurrikulat e caktuara që studentët i studiojnë duke zgjedhur lëndë zgjedhore kanë profil të kuptueshëm dhe të mirë. Kjo mund të arrihet duke bërë rregulla të përshtatshme të cilat do të kufizonin mundësitë për të kombinuar lëndët zgjedhore, dhe apo kjo do të mund të arrihej përmes këshillimit të obligueshëm.

9.2 Rekomandime për stafin akademik:

Në mënyrë që të implementohet ky program, duhet të ketë numër permanent dhe të mjaftueshëm të stafit akademik i cili ka kualifikime të mira. Posaçërisht masa duhet të merren për siguruar se së paku një pozitë gjithmonë mbahet nga një person i cili si gjuhë amtare ka gjuhën angleze dhe i cili ka kualifikime të TEFL.

Përmbledhje

Programi Master Menaxhment/ MA”

Programi Master në Menaxhment/ MA rekomandohet të ri akreditohet për një periudhë tre vjeçare.

Programi Bachelor Gjuhë dhe Letërsi Angleze/ BA”

Programi Bachelor në Gjuhë dhe Letërsi Angleze (BA) **nuk** rekomandohet për akreditim.